



Flyer ,Unterricht in der Herkunftssprache: Ein Gewinn!‘ Übersetzung Albanisch

Mësim në gjuhën e origjinës: Një fitim!

Flisni në shtëpi një gjuhë tjetër përveç gjermanishtës? Çfarë thesari për fëmijun tuaj! Sepse fëmijët, të cilët gjuhën amtare e flasin mirë, mësojnë më lehtë gjuhën gjermane dhe gjuhët e huaja. Për këtë qëllim mundësojani fëmijut tuaj mësimin në gjuhën dhe kulturën amtare (HSK). Në shkollat në Basel-Stadt dhe Basel-Landschaft mësimi në gjuhën amtare mbahet në më shumë se tridhjetë e gjashtë gjuhë.

Kush flet dhe njeh mirë gjuhën amtare, ai mëson lehtë edhe gjuhët tjera. Këtë e dëshmojnë edhe hulumtimet shkencore. Këtë lehtësim mësueset dhe mësuesit e përjetojnë çdo ditë në mësim. Mësimi në HSK sjell edhe më shumë përparësi:

- Fëmiju juaj njihet me fëmijë të tjerë, të cilët flasin gjuhën e njëjtë.
- Përmes mësimi të gjuhës krijohen më lehtë edhe kontaktet me farefis dhe me ata që njiheni.
- Mund të flasin në gjuhën amtare dhe të ndjehen më pak të huaj.
- Përjetojnë kulturë dhe vlera të ndryshme.
- Janë krenar për njohurit e tyre dhe duan të mësojnë gjuhë të tjera.
- Më vonë sjellë përparësi në jetën profesionale.

Çfarë mësohet?

Fëmijët dhe të rinjtë mësojnë më mirë ta kuptojnë gjuhën, të folurit, leximin dhe shkrimin. Ata përjetojnë kulturën dhe merren me historinë, gjeografinë, me të drejtat e qytetarit, ushqimin, festat dhe me zakonet. Mësueset dhe mësuesit e shkolluar mbajnë mësim me shumë dëshirë.

Ku dhe sa shpesh mbahet mësimi?

Mësimi mbahet njëherë në javë në shkollat publike, nëse ka mundësi mbahet në shkollën e njëjtë ku fëmiju juaj shkon në shkollë ose në afërsi. Këtë ofertë për mësim e financojnë ambasadat e shteteve të origjinës së fëmijëve ose shoqatat e prindërve. Ju si prindër kryesisht paguani vetëm një shumë.

Si mund ta ndihmoni fëmijun tuaj në shtëpi?

- Flisni në shtëpi me fëmijun tuaj në atë gjuhë, në të cilën ju më së shumti mendoni dhe ëndërroni. Mos hiqni dorë nga gjuha e juaj amtare, edhe kur fëmiju juaj përgjigjet në gjermanisht.
- Zgjidhni gëzim tek fëmiju juaj për gjuhën amtare. Tregoni përralla, dëgjoni fëmijun kur flet dhe këndoni së bashku me të.
- Jepni material në gjuhën amtare: Libra, CDs me këngë dhe përralla, filma.
- Mbështesni kontaktet me fëmijët, të cilët flasin gjermanisht ose ndonjë gjuhë tjetër.
- Ruani kontaktet me mësueset dhe mësuesit të shkollës dhe të mësimi në HSK.

Lajmërimi për mësimin në HSK

Ju lutemi lajmëroni fëmijun tuaj direkt te mësuesja ose mësuesi i klasës. Mbi 4000 fëmijë shkojnë tani në mësim në HSK në Basel-Stadt dhe Basel-Landschaft.

Kantonale Kontaktadressen

Daniel Aeschbach
Erziehungsdepartement Basel-Stadt | Volksschulen
Fachstelle Pädagogische Unterstützung
Kohlenberg 27 | Postfach | 4001 Basel
Tel. +41 61 267 90 08 | daniel.aeschbach@bs.ch
www.bs.ch/hsk

Bildungs-, Kultur- und Sportdirektion Kanton Basel-Landschaft
Amt für Volksschulen
Sekretariat
Munzachstrasse 25c, Postfach 616, 4410 Liestal
Tel. +41 (0)61 552 50 98, avs@bl.ch
www.hsk.bl.ch